



# DEMOKRACIA KA



# NJË MESAZH PËR TY

# TË MIRAT E DEMOKRACISË

ARBEN (13), ALT (13), ENDI (13), BORA (13), ALBERINA (13), ERT (12), ELA (13), ALBA (13), FESTA (13)




**Demokracia ka vlerë kaq të madhe sa nuk mjafton vetëm një artikull për të treguar për të. Megjithatë, ne kemi tentuar të tregojmë rëndësinë e saj përmes këtij artikulli**

Ndonjëherë mund të na ndodhin gjëra edhe jo shumë të këndshme. Për shembull, një shoqe e klasës sonë, na ka treguar një rast kur ajo nuk është ndier aspak mirë. Para se të vinte në klasën tonë, ajo ka qenë pjesë e një klase ku ekzistonin paragjykimet fe-

pavarësisht fesë. E këtë barazi e kemi edhe për sa i përket gjinisë, racës, etj. Këtë histori e treguam në mënyrë që edhe ju, të dashur lexues, të nxjerrni një mësim. Kjo gjë nuk duhet të ndodh në asnjë rrethanë. Diskriminimi është gjë që nuk tolerohet aspak në demokraci.

Që nga ajo ditë në klasën tonë nuk ekziston asnjë paragjykim. Ky rast na bëri që të reflektojmë shumë. Klasa jonë u bë edhe më e mirë se që ishte, sepse ne nxënësit e saj ishim më të bashkuar. Pra, ne duhet t'i zbatojmë elementet e demokracisë, që janë: barazia, liria, toleranca, paqja, drejtësia, etj.

Ky sistem i qeverisjes është shfaqur në vitin 507 p.e.s. në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Demokracia mund të ekzistoj në dy forma: në demokraci të drejtëpërdrejtë dhe në demokraci përfaqësuese. Ne iu kërkujmë që të mos i shkelni të drejtat e të tjerëve, pasi që të gjithë jemi të barabartë.



tare. Aty ishin vetëm dy vajza të cilat iu përkisnin një feje tjetër nga shumica e klasës. Njëra ndër to ishte vetë shoqja jonë. Ato nuk konsideroheshin si pjesë e klasës nga nxënësit e tjerë. Në çdo aktivitet që bënin nxënësit e klasës, ato i linin anash dhe iu thonin se ishin më ndryshe nga ta.

Kur shoqja jonë erdhi në klasën tonë, ajo rrëfeu këtë histori tek ne. Ne përveç se atë nuk e dallojmë, morëm edhe një mësim se të gjithë jemi të barabartë



Gazetarët më demokratikë

# FUQIA E POPULLIT E NDARË NË TRI PJESË

VALMIRA (13), DRILON (13), DORISA (13), DORI (13), RITA (12), SHENDI (12), SIONA (13), HASIJE (13)



**Në shtetin tonë, shumica e qytetarëve janë mësuar që çdo herë punët t'i kryejnë në mënyrë individuale. Por, nëse ne tentojmë që punët tona t'i kryejmë duke bashkëpunuar me të tjerët, gjithçka do të përfundojë më shpejt dhe me rezultate më të mira**

Ne në Kosovë kemi një formë të veçantë të qeverisjes. Është fjala për demokracinë, e cila do të thotë udhëheqje nga populli. Ne qytetarët kemi fuqinë në duart tona. Kjo fuqi na jep neve të drejtën që të marrim vendime për veten, por edhe të zgjedhim disa persona të cilët do të na përfaqësojnë neve. Këta persona janë deputetët, të cilët punojnë në Kuvendin e Kosovës. Ky institucion ushtron atë që njihet si Pushteti Legjislativ. Përveç Pushtetit Legjislativ, ne kemi edhe Pushtetin Gjyqësor dhe atë Ekzekutiv. Këto tri pushtete, kanë funksione të ndryshme, por ato bashkëpunojnë vazhdimisht me njëra-tjetrën.

Pushteti Legjislativ është pushtet që miraton ligje. Ligjet e miratuara nga Kuvendi i vë në funksion Pushteti Ekzekutiv. Kurse, Pushteti Gjyqësor merr masa ndaj atyre qytetarëve të cilët nuk i zbatojnë ato ligje. Pushteti Ekzekutiv përfaqësohet nga Qeveria, e cila funksionon nën udhëheqjen e Kryeministrit. Në kuadër të këtij institucioni ka shumë ministri, të cilat na mundësojnë një jetë më të mirë dhe një shtet më të zhvilluar. Disa nga këto ministri janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që merret me të gjitha çështjet arsimore në vend; Ministria e Drejtësisë që merret me sundimin e ligjit dhe me drejtësinë në shtet; Ministria e Shëndetësisë që merret me shërbimet shëndetësore për qytetarët e vendit tonë, si dhe

shumë ministri të tjera.

Ndarjen e pushtetit ne ndryshe mund ta shpjegojmë me një shembull të thjeshtë. Ju kujtohet „Historia e Skënderbeut“ dhe fjalët e tij të fundit para se të ndërronte jetë? Ai u tha shokëve të vet: „Të dashurit e mi, duhet të qëndroni të bashkuar sikur grumbulli i shkopinjve, sepse vetëm atëherë do të jemi më të fortë“. E njëjta gjë ndodh edhe me degët e pushtetit. Ato janë institucione të ndara, por prapëseprapë punojnë së bashku drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta.

Porosia jonë për ju është po ashtu e thjeshtë: mos u bëni lakmitarë dhe bashkëpunoni me njëri-tjetrin. Vetëm në këtë mënyrë do të shkojmë përpara.

Edhe ne sot funksionuam në këtë mënyrë. Kishim role të ndara, por vazhdimisht ishim në përkrahje të njëri-tjetrit. Kështu e përfunduam punën tonë si gazetarë të suksesshëm.




Së bashku i arrijmë qëllimet tona



Në këta rrahët që po i shihni kemi shkruar disa elemente kryesore të demokracisë. Lexojini me kujdes dhe mendoni se sa të rëndësishme janë ato për ne. Ndërsa, vizatimi i dytë tregon se në demokraci vërtet ne qytetarët udhëheqim




Fjala demokraci rrjedh nga fjalët e gjuhës greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Përmes fjalës demokraci mund të kuptojmë se kush e ka fjalën e parë dhe të fundit në këtë sistem të qeverisjes



Data 17 shkurt është data më e dashur për ne. Pikërisht në këtë datë shteti ynë është shpallur shtet i pavarur dhe demokratik. Kurse, ligjet e reja duhet të jenë gjithmonë në përputhje me nevojat tona si qytetarë të Kosovës

# PUNËT E KUVENDIT TË KOSOVËS

FIS (13), BUNA (13), VESA (12), SARA (12), OLTİ (13) MEDIN (13), XHYLJETA (14), ERZA (13)



## Përmbajtja e këtij artikulli flet për punët e Kuvendit të Kosovës. Por jo vetëm... Vazhdoni leximin që të mësoni më shumë

Këtë artikull do ta fillojmë duke iu treguar një ngjarje që na ka ndodhur neve. Kjo ngjarje ka ndodhur në një Konferencë për të Drejtat e Fëmijëve, pjesë e së cilës ishim edhe ne. Ishte një rast shumë i veçantë për ne të dëgjojmë një debat shumë domethënës që bënë shqiptarja Zana, serbja Dragana dhe turku Kemali. Le të ndjekim bisedën e tyre.

Zana filloi: „Zoti Kemal, ju jeni një qytetar me etni turke dhe si i fillë mund të bëheni edhe deputet i Kuvendit të Kosovës, sepse shtetësia juaj është kosovare. Kjo gjë vlen edhe për ty Dragana, sepse edhe ju keni shtetësi kosovare. Ju jeni të barabartë me mua dhe me të gjithë qytetarët e tjerë të Kosovës.“ Kemali vazhdoi: „Faleminderit Zana. Unë jam shumë i gëzuar që jetoj në një shtet ku edhe unë mund të kandidoj për deputet.“ Kurse, Dragana komentoi: „Por, gjithashtu faleminderit demokracisë që na lejon të trajtohem në

mënyrë të barabartë dhe me dinjitet.“

Pra, çdo qytetar i/e cili/a është pjesë e komunitet shqiptar, serb, ashkali, egjiptian, romë, boshnjak, goran; por është qytetar i regjistruar i Kosovës mund të bëhet deputet/e i/e Kuvendit të Kosovës. Kjo ishte biseda që dëgjuam, e cila na u duk shumë interesante.


Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë të komuniteteve të ndryshme dhe kryesisë së tij. Deputetët ndahen në pozitë dhe opozitë dhe që të gjithë nxjerrin ligje të Kosovës. Në Kuvend punojnë 100 deputetë shqiptarë, 10 serbë dhe 10 të tjerë të cilët janë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë të sapopërmendura.

Për këta deputetë, ne dalim dhe votojmë në zgjedhjet parlamentare. Votat tona janë e vetmja formë përmes së cilës ata fitojnë këtë rol. Deputetët më pas e formojnë Qeverinë, e cila ka për detyrë të ekzekutojë ligjet. Ata po ashtu e zgjedhin Presidentin, i cili ka më shumë rol përfaqësues. Përveç deputetëve, kemi edhe Kryetarin e Kuvendit i cili mban rregullin gjatë seancave plenare. Mandati i tyre, përveç atij të Presidentit, zgjat 4 vjet.

Kurse, në vazhdim do të mund të gjeni fakte mbi funksionet e Kuvendit. Funkzioni legjislativ përshkruan detyrën e deputetëve për të miratuar ligje; funksioni kontrollues do të thotë se Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë; ndërsa funksioni përfaqësues ka të bëjë me rolin shumë të rëndësishëm të deputetëve, e që është përfaqësimi i popullit. Është i fillë, pasi që ne kemi nevojë për dikë të na përfaqësojë dhe të punojë në interesin tonë. Faleminderit për leximin.



Autorët pas kësaj pune kaq të madhe



## IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Yll Morina“  
Klasa: VII-4  
Vendi: Gjakovë